



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:006061  
Datë: 18.04.2024  
Numri i dokumentit: 05589278

**Në çështjen juridike të :** **AC-I-23-0139-A0001**

*Paditësi*

**I F**, Podujevë, me përfaqësues sipas autorizimit, avokatin B I, Prishtinë

**Kundër:**

*E paditura/Ankuese*

**N.SH “Zahir Pajaziti”** (në likuidim), e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-3324, të datës 16 shkurt 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 18 prill 2024, lëshon këtë:

## A K T G J Y K I M

1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-3324, i datës 16 shkurt 2023.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 29 prill 2014, ankuesi kishte paraqitur një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN046-0528 të datës 26 dhjetor 2013, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për kompensim për 3 pagat e fundit të papaguara në shumën prej 1,046.11 euro për periudhën

nga janar 2006 deri në mars 2006 ishte refuzuar si e pavlefshme, për faktin se e njëjta ishte parashkruar. Në ankesë theksohet se paditësi në rastin konkret ka vepruar sipas ligjit dhe udhëzimeve të AKM-së pra ka marrë letrën zyrtare për ndërprerje të marrëdhënies së punës me të cilën është udhëzuar që ai të kontaktohet kur të filloj procedura e likuidimit. Autoriteti i Likuidimit në rastin konkret në mënyrë arbitrare ka refuzuar kërkesën e tij kinse është e parashkruar pa asnjë bazë ligjore. Andaj, i njëjti i kishte propozuar gjykatës që të anuloi vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe ta urdhëroj AKP-në që të miratoj kërkesën e paditësit në shumën e përcaktuar si dhe 10% interes ligjor.

Ankesës i kishte bashkëngjitur këto prova: autorizimin për përfaqësim, vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN046-0528 të datës 26 dhjetor 2013, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit të datës 24 mars 2006, llogaritjen e 3 pagave të fundit ashtu siç e parasheh ligji për paditësin I F, si dhe listën e përfituesve të 20%.

Me datë 15 prill 2022, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën kishte theksuar se parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit për AKP-në është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 74.2. të Ligjit për DHPGJS-në i cili parashikon se ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin për AKP-në. AKP-ja kishte konsideruar se kërkesa e paditësit do të duhej të ishte paraqitur në ndonjë gjykatë apo ndonjë autoritet kompetent brenda tre vjetëve nga momenti kur N.SH nuk ka përmbushur ndaj parashtruesit obligimet e saj që rrjedhin nga marrëdhënia e punës që është tre vjet nga koha kur parashtruesi kishte fituar të drejtën për të parashtruar kërkesën për të kërkuar dëmshpërblim për rrogat e papaguara që është mars 2006. Andaj, AKP-ja kishte propozuar që të refuzohet ankesa e paditësit si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur vendimin për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 30 maj 2022, paditësi kishte paraqitur përgjigje në mbrojtje të AKP-së në të cilën i kishte përsëritur pretendimet e saj si në ankesë dhe i kishte propozuar gjykatës që të aprovoj kërkesën e paditësit. Përgjigjes i kishte bashkëngjitur: njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 24 mars 2006, kopjen e librezës së punës së paditësit, si dhe llogaritjen e 3 pagave të fundit të papaguara të N.SH-së ndaj paditësit.

Me datë 14 qershor 2022, AKP-ja kishte paraqitur kundërpërgjigje në përgjigjen e paditësit duke i propozuar gjykatës që të refuzoj parashtresën e paditësit si të pabazuar dhe të vërtetoj vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Kundërpërgjigjes i kishte bashkëngjitur vendimin për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit dhe listën e pagave të llogaritura për tre muaj për punëtorët e N.SH FAN “Zahir Pajaziti”.

Me datë 16 shkurt 2023, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-3324 kishte aprovuar si të bazuar ankesën e paditësit, duke obliguar AKP-në që ankuesit në emër të kompensimit të tri pagave të papaguara t’i paguaj shumën prej 1,046.11 euro si dhe në emër të interesit ligjor shumën prej 104.61 euro. Gjithashtu gjykata kishte obliguar AKP-në që ankuesit në emër të përpilimit të ankesës dhe përgjigjes ndaj përgjigjes së AKP-së t’ia paguaj shumën prej 208 euro, ndërsa pjesën e mbetur prej 104.00 euro në emër të kërkesës kreditore e kishte refuzuar. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi theksohet se në rastin konkret ankuesi kishte arritur që të dëshmoj se ka qenë punëtor i N.SH-së në kohën e privatizimit të tij dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuar si rrjedhojë e vendimit/veprimit të AKP-së. AKP-ja asnjëherë nuk e kishte kundërshtuar shumën e kërkuar nga ana e ankuesit, respektivisht nuk e kishte argumentuar të kundërtën me çka ankuesit do ti mohohej e drejta në kompensimin e pagave. Lista e pagave, librezat e punës dhe njoftimi i parashtruar nga ankuesi si dhe lista e punëtorëve argumentojnë faktin se i njëjti ka qenë punëtor aktiv i N.SH-së deri me datën e privatizimit, respektivisht 24 mars 2006, kohë kjo kur edhe u privatizua N.SH-ja. Andaj nga arsyet e cekura më lartë, gjykata konsideron se ankuesi ka arritur që të dëshmoj të drejtën në kompensim të tri pagave të papaguara në shumën e lartcekur.

Me datë 9 mars 2023, AKP-ja (ankuesja) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-14-3324 të datës 16 shkurt 2023 (Aktgjykimi i ankimuar), duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të ndryshoj Aktgjykimin e ankimuar dhe të vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Në ankesë theksohet se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra dhe atë se ekzistojnë dy afate të ndryshme të parashkrimit të cilat Autoriteti i Likuidimit e ka për obligim t’i pranoj dhe përmes të cilave Autoriteti i Likuidimit aplikon në mënyrë të drejtë ligjin. Afati i parë ka të bëjë me “Afatin për parashtrimin e kërkesave” që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurë të likuidimit dhe afati i dytë që ka të bëjë me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën parashtruesi ka kërkuar të zbatohet në kërkesë. Dy afatet e lartcekura janë të ndara dhe të dallueshme dhe një kreditor duhet t’i përmbushë të dy afatet në mënyrë të kërkesa e tij të pranohet. Andaj, Autoriteti i Likuidimit

fton DHPGJS-në që të lëshohet edhe njëherë në shqyrtim të çështjes në fjalë dhe të konsideroj argumentet e Autoritetit të Likuidimit që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtave të parashtruesve e që këto kufizime Autoriteti i Likuidimit është i obliguar që t'i zbatoj ex officio. Andaj, Kolegjit të Apelit i kishte propozuar si më lartë. Ankesës i kishte bashkëngjitur Aktgjykimin e ankimuar, vendimin e Autoritetit të Likuidimit dhe vendimin për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit të datës 1 nëntor 2022.

Me datë 11 janar 2024, paditësi kishte paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës në të cilën i propozon Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të refuzohet si e pabazuar ankesa e ankueses, ndërsa të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të detyrohet e paditura të bëj kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në shumë prej 208.00 euro.

### **Arsyetimi i ligjor**

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për kompensimin e 3 pagave të fundit të papaguara në shumën prej 1,046.11 euro ishte refuzuar si e pavlefshme me arsyetimin se afati kohor kur paditësi kishte parashtruar kërkesën e tij për realizimin e së drejtës së tij të pretenduar, e njëjta ishte parashkruar

Paditësi në shkallë të parë kishte bashkëngjitur provat si në vijim: autorizimin për përfaqësim, vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN046-0528 të datës 26 dhjetor 2013, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit të datës 24 mars 2006, llogaritjen e 3 pagave të fundit ashtu siç e parasheh ligji për paditësin I F, si dhe listën e përfituesve të 20%.

Shkalla e parë e DHPGJS, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin i kishte njohur paditësit të drejtën në kompensim të 3 pagave të fundit të

papaguara për periudhën janar-mars 2006 në shumën prej 1,046.11 euro me arsyetimin se i njëjti kishte dorëzuar prova relevante që dëshmonin se N.SH në fjalë ka detyrim ndaj paditësit këtë shumë.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS kishte vepruar drejtë me rastin e marrjes së vendimit, ndërsa konsideron se ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Kjo për faktin se nga librezja e punës së paditësit shihet që paditësi kishte ofruar shërbime për N.SH “Zahir Pajaziti” deri me 24 mars 2006, pra kur edhe ndërmarrja në fjalë ishte privatizuar.

Provë relevante në këtë rast ishin edhe listat e pagave të parashtruara si provë nga ankuesi si dhe njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës që dëshmojnë faktin se i njëjti ka qenë punëtor i N.SH-së dhe se N.SH i ka mbetur borxh shumën e pretenduar prej 1,046.11 euro.

Sa i përket pretendimeve të së paditurës në ankesën e saj të paraqitur në shkallë të dytë, Kolegji i Apelit vlerëson se ashtu siç me të drejtë thekson shkalla e parë, e paditura nuk ka paraqitur asnjë argument me të cilin do të dëshmonte të kundërtën e asaj që ka provuar paditësi.

Prandaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, Kolegji i Apelit konsideron se shkalla e parë ka vepruar drejtë kur paditësit i ka njohur të drejtën në kompensim të 3 pagave të papaguara për periudhën e lartcekur dhe në shumën prej 1,046.11 euro.

Nga arsyet e cekura më lartë, ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 28 mars 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 18 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues \_\_\_\_\_